



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, si dhe nenit 4 dhe 10 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e dates 28.06.2019, Rekomandimit të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të datës 12.08.2020, si dhe duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-34198 të datës 06.08.2020 të Bahti Terpeza nga fshati Ribar i Madh, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 1500 € (një mijë e pesëqind) euro, Bahti Terpezës nga Ribari i Madh, sipas kërkesës të tij 1Nr.400-34198 të datës 06.08.2020, për ta mbështetur financiarisht në renovimin e shtëpisë, në pajtim edhe me Rekomandimin e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i datës 12.08.2020, i cili i ka rekomanduar Kryetarit të Komunës që brenda mundësive financiare të ndihmohet në renovimin e shtëpisë, përshkak të gjendjes së rëndë ekonomike, bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar në teren.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2020, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të paraqitësit të kërkesës në nr. 1300003600641058 në BPB Bankë.

Neni 3

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell dëshmi-faturë deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Sektorin për përfaqësim dhe çështje ligjore më së largu me datë 25.12.2020.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale si dhe Bahti Terbeza nga Ribari i Madh.

1Nr. 400-34198
Lipjan, më 12.08.2020

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

